




## Struktura e të dalave dhe numri i të punësuarve në institucionet e paraqitura në Buxhet



SHUMAT JANË NË MILIONË EURO



SHUMAT JANË NË MILIONË EURO



Në vitin 2016 shuma e pagave të administratës qendrore në Buxhet ka qenë mbi **421 milionë euro**, që paraqet një rritje prej më shumë se **36 milionë euro** krahasuar me Buxhetin e vitit 2014.

Numri i të punësuarve në institucione për të cilat Qeveria jep të dhëna në Buxhetin për vitin 2016 është **52.885**, por kjo nuk paraqet numrin e përgjithshëm të të punësuarve në administratën shtetërore dhe publike, me çka vazhdon shfaqja e pasqyrës së rrejshme për numrin përgjithshëm të të punësuarve në administratë.

Megjithatë, numri për të cilin japin të dhëna është më i lartë për **3.557** të punësuar krahasuar me vitin 2014, gjegjësisht, më shumë se **12.000** krahasuar me vitin 2006. Kjo tendencë tregon se Qeveria do të vazhdon edhe në vitin zgjedhor 2016 me strehimin e ushtarëve të vet partiak në administratën shtetërore. Këtë e tregon edhe e dhëna për shumën e rritur për punësime të përkohshme e cila është **1,7 milionë euro**.

Një e treta e Buxhetit është paraparë për beneficionet sociale, gjegjësisht për pagesën e pensioneve (791 milionë euro), për mbrojtje shëndetësore të qytetarëve (406 milionë euro) dhe për pagesën e ndihmës sociale (126 milionë euro). Nëse këto shuma mblidhen me kujdes, do shihni se totali është **1,32 miliardë euro**, që është shumë më e madhe për **263,8 milionë euro** më e madhe prej **1,06 miliardë euro** të planifikuar në Buxhet. Edhe në vitin 2016, Qeveria do të blen paqen sociale dhe do të mbulon deficitin buxhetor me borxhe në vend dhe jashtë vendit.

Në vitin 2016 Qeveria planifikon të shpenzon **480 milionë euro** për konsulentë të jashtëm, shumë që është më e madhe për **72 milionë euro** nga shuma e të dalave kapitale me të cilat Qeveria lavdërohet se në vitin 2016 do të jenë 12,9% më të larta krahasuar me vitin 2015.



**421,23**  
milionë euro

paga për administratën qendrore



**52.885**  
të punësuar

në institucionet e paraqitura në Buxhet



**480,05**  
milionë euro


për konsulentë të jashtëm



**1,7**  
milionë euro

për punësime të përkohshme

## Struktura e të dalave 2016 (beneficione sociale, shërbime kontraktuale dhe të dala kapitale)



SHUMAT JANË NË MILIONË EURO



FOUNDATION  
OPEN SOCIETY  
SOCIETY  
MACEDONIA